

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-26-4117-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e pastrimit të rrobave dhe mbulesave për nevojat e FSK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ECO CLEAN CORPORATION SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hasan Prishtina Obiliq
(Adresa)

Obiliq
(Vendi)

15000
(Kodi postar)

+38343771991
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arber Gashi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

argashi2020@gmail.com
(Adresa elektronike)



24.08.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: Nuk parashtrohet përmes Avokatit

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë është publikuar me datë 03.06.2026
Hapja e tenderit 16.07.2026
Kriteri i dhenjes- Cmimi më i ulët
Njoftimi mbi vendimin 06.08.2026
Kërkese për rishqyrtim 11.08.2026
Pergjigjja ndaj kerkeses për rishqyrtim 14.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datë 11.08.2026 përmes kerkese për rishqyrtim kemi paraqitur pretendimet tona pran AK por me datë 14.08.2026 e ne jeta na është refuzuar si e pa bazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP:

Neni 1 Qellimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 57 Sigurimi i tenderit

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
RRPP**

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

UPP

Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 06.08.2026 kemi pranuar përmes Platformës Elektronike E-Prokurimi Njoftimin mbi vendimin e AK si dhe letren standarde për tenderuesin e eliminuar dhe njoftimin për rekomandimin për kontratë OE A.L.Dushi SHPK

Bazuar në **Nenin 10 të LPP-së** (Mjetet për promovimin e transparencës), kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumente dhe e njëjta na është aprovuar nga AK.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, **konform Nenit 108/A të LPP-së**, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK, e njëjta na është refuzuar, si rrjedhojë paraqesim këtë ankesë pranë OSHP-se për arsye të mëposhtme:

Bazuar në njoftimin mbi vendimin e AK-së, është shpërblyer me kontratë OE A.L.Dushi SHPK. Ky vendim është i paligjshëm, i paarsyetuar, dhe si i tillë duhet të anulohet.

Komisioni i vlerësimit respektivisht Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit, shqyrtimit dhe krahasimit të ofertave ka bërë shkelje të NENIT 59 të LPP-së dhe NENIT 40 të RRPP-së duke rekomanduar për kontratë një OE i cili është krejtësisht i papërgjegjshëm dhe nuk plotëson kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit ndërsa në anën tjetër duke eliminuar neve dhe rrjedhimisht duke shkelur Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi duke favorizuar OE A.L.Dushi SHPK

I. Sigurimi i Tenderit i dorëzuar nga OE i propozuar nuk përputhet me formën dhe kërkesat standarde të kërkuar në dosjen e tenderit

Sigurimi i tenderit i dorëzuar nga OE i propozuar për dhënie të kontratës, A.L.Dushi SHPK, nuk është konform formës dhe kërkesës së Dosjes së Tenderit, si dhe është në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren për Prokurim Publik, konkretisht me Nenin 57 të

AK në dosjen e tenderit, përmes Aneksit 4 Siguria e Tenderit, ka përcaktuar një format të saktë dhe të detyrueshëm të sigurimit, i cili përmban deklarata dhe kushte specifike që garantuesi duhet t'i pranojë, ndër to:

- Konfirmimin se garantuesi zotohet të paguajë shumën e siguruar sipas kërkesës së parë me shkrim, në rast se deklarohet mospërbushja e njërit prej kushteve;
- Kushtet konkrete të pagesës, përfshirë rastet kur: (a) Autoriteti Kontraktues konstaton se tenderuesi ka dhënë informacione të gabuara ose mashtruese; (b) tenderuesi tërheq tenderin pas skadimit të afatit për dorëzim, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit; (c) tenderuesit i është dhënë kontrata dhe ai refuzon apo dështon të depozitojë sigurinë e ekzekutimit, të plotësojë kushtet parapriuese për nënshkrimin e kontratës, apo të lidhë kontratën në përputhje me kushtet e specifikuar.

Ky format nuk është thjesht sugjerues apo ilustrues por përbën kërkesë të detyrueshme dokumentare, pasi vetëm përmes këtyre deklaratave specifike Autoriteti Kontraktues siguron mbrojtje efektive juridike dhe financiare në rast se tenderuesi shkel detyrimet e tij pas dorëzimit të ofertës.

Dokumenti i dorëzuar nga OE i propozuar edhe pse referon shumën e siguruar, kohëzgjatjen dhe titullin e kontratës, nuk përmban asnjë prej deklaratave dhe kushteve specifike (a, b, c) të cekura në formën standarde të Aneksit 4 të Dosjes së Tenderit. Në vend të një sigurimi sipas kërkesës së AK-së, OE ka dorëzuar një dokument të përgjithshëm, i cili nuk e pasqyron dhe nuk e përmban strukturën dhe kushtet e detyrueshme të përcaktuara nga vetë dosja e tenderit.

Kjo do të thotë se sigurimi i dorëzuar nuk ofron mbrojtjen juridike dhe kushtet specifike që AK vetë i ka konsideruar të domosdoshme, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si dëshmi e vlefshme e sigurisë së tenderit sipas kërkesave të dosjes.

AK, në vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim, nuk e mohon dhe as nuk e konfirmon në mënyrë specifike praninë e këtyre tri kushteve në policë, përgjigjja e tyre është e përgjithshme se "polica i përmban të dhënat bazë të kërkuara" dhe se "dallimet në paraqitjen grafike ose renditjen e klauzolave nuk përbëjnë mungesë të sigurimit". Kjo përgjigje nuk adreson thelbin e pretendimit tonë: nuk është fjala për dallime grafike apo renditje, por për mungesë të plotë të përmbajtjes së vetë deklaratave (a), (b), (c) të cilat janë elementi thelbësor të sigurisë së tenderit.

Udhëzuesi për Prokurim Publik, Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, e parashikon këtë rast konkret si shkak refuzimi absolut, pa mundësi kërkesë për informacion shtesë:

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
--	---	----

Kjo dispozitë e Udhëzuesit eliminon çdo mundësi që të kërkohej sqarim, plotësim apo zëvendësim të sigurimit, rasti në fjalë nuk bën pjesë në kategorinë e mangësive që mund të

sqarohen sipas Nenit 72 të LPP-së, por duhet refuzuar ofertën automatikisht.

Forma ne dosjen e tenderit.

Titulli: Shërbimet e pastrimit të rrobave dhe mbulesave për nevojat e FSK-së me numer prokurimit 217-26-4117-2-1-1 dhe me numer brendshem 217-26-038-211

Aneksi 4. SIGURIA E TENDERIT

Për: **MINISTRIA E MBROJTJES**

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]

(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Shërbimet e pastrimit të rrobave dhe mbulesave për nevojat e FSK-së**

Numri i Prokurimit: **217-26-4117-2-1-1**

Garancion me kërkesë te parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: < shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
 - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
 - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me: <data dhe koha >

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Emri i institucionit financiar


Adresa

Data

Sigurimi i dorëzuar nga OE A.L.Dushi SHPK



11565

POLICA E SIGURIMIT TË GARANCISË GUARANTEE INSURANCE CERTIFICATE				Nr.policës Policy No	26/26
I SIGURUARI DEBITORI KRYESOR	A.L. DUSHI SH.P.K.		SPECIALISTI/AGJENTI	LORIK PAÇARADA	
NUMRI I BIZNESIT	811250860		KODI I SPECIALISTIT AGJENTIT	24	
NUMRI FISKAL	600115548		DREJTORIA/FILIALI AGJENTIT	PRISHTINË	
ADRESA	PRISHTINË, 10000, KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM. B. NR.5		NUMRI I BIZNESIT SIGURUESI	811300722	
PERFAQESUESI DEBITORI SOLIDAR	XHYLIZARE SELIMI DUSHI		NUMRI FISKAL SIGURUESI		
NUMRI PERSONAL IDENTIFIKUES	1001132527		ADRESA E DREJTORISË SIGURUESI	Rr. "Xhevdet Doda", p.n., Prishtinë	
SIGURIMI/GARANCIA FILLON ME:	16.07.2026		PRIMI I SIGURIMIT	30.00 €	
SIGURIMI/GARANCIA PËRFUNDON ME:	13.11.2026		TATIMI I VLERËS SË SHËTUAR 18%	5.40 €	
SHUMA E SIGURUAR	1,500.00	€	SHUMA PËR PAGESE	35.40 €	
DATA E LËSHIMIT TË POLICËS	01.07.2026		DATA E PAGESES	01.07.2026	
PËRFITUESIA/AUTORITETI KONTRAKTUES	MINISTRIA E MBROJTJES				
ADRESA	Prishtinë, KAZERMA ADEM JASHARI				
TITULLI I KONTRATËS:	SHËRBIMET E PASTRIMIT TË RROSAVE DHE MBULESAVE PËR NEVOJAT E FSK-SË				
NUMRI I IDENTIFIKIMIT PROKURIMIT	217-26-4117-2-1-1				
LLOJI I SIGURIMIT GARANCISË	SIGURIMI I GARANCIONIT TË OFERTËS / BID BOND INSURANCE				
ÇERTIFIKATA E GARANCISË DHE KJO POLICË SIGURIMI VËRTETOJNË LIDHJEN E KONTRATËS, DHE LËSHOHEN NGA SIGURUESI NË BAZË TË DEKLARIMEVE DHE KËRKESAVE TË BËRA NGA PËRFAQESUESI I TË SIGURUARIT, I CILI ËSHTË PËRGJEGJËS LIDHUR ME SAKTËSINË DHE VËRTETËSINË E DEKLARIMEVE TË BËRA PREJ TËJ UNË PËRFAQESUESI I TË SIGURUARIT, PASI I LEXOVA ME VËMENDJE DHE I KUPTOVA KUSHTET E KONTRATËS SË SIGURIMIT, DEKLAROJ SE PAJTOHEM ME TO, SI DHE ME TË DHENAT DHE PËRCAKTIMET E ÇERTIFIKATËS SË GARANCISË DHE TË KËSAJ POLICË SIGURIMI, DHE PO NËNSHKRUAJ KONFORM VULLNETIT TËM TË LIRË, E TË PLOTË					
I SIGURUARI			SIGURUESI	 KS "Dukagjini" sh.a.	

K.S. Dukagjini SH.A. Adresa: Xhevdet Doda, Obj. Dukagjini Residence Hy. A1 Kati 1, 10.000, Prishtinë
Tel: +383 (0) 43 770 077; +383 (0) 48 750 005, E-mail: info@dukagjiniks.com, www.dukagjiniks.com

II. Mospërmbushja e kriterëve të Kapacitetit Teknik dhe Profesional - Referencat pa vlerë të specifikuar

OE i propozuar për kontratë, A.L.Dushi SHPK, nuk i përmbush kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit lidhur me Kapacitetin Teknik dhe Profesional. Referencat e prezantuara nga ky OE janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk duhej të ishin pranuar fare nga Komisioni Vlerësues.

Dosja e tenderit për çështjen e referencave është krejtësisht e qartë dhe pa asnjë hapësirë interpretimi, ku thuhet:

"Për kontratat e realizuara për autoritete publike ose private, brenda ose jashtë

Republikës së Kosovës, duhet të dorëzohen referencë pozitive ose fletëpranim ose raport pranimi teknik të lëshuara nga autoriteti përkatës, **ku specifikohet edhe vlera e kontratës, në të kundërtën, nuk do të merret parasysh."**

Kjo dispozitë nuk lë asnjë diskrecion për Komisionin e Vlerësimit, fjala "në të kundërtën, nuk do të merret parasysh" për Komisionin e Vlerësimit respektivisht AK është obliguese që të trajtojë ofertën konform kësaj kërkesë. AK e ka vendosur këtë kusht si kërkesë minimale të domosdoshme e të detyrueshme, çka do të thotë se çdo devijim nga ky kriter skualifikon automatikisht, pa marrë parasysh elemente të tjera të ofertës.

Referencat e mëposhtme të paraqitura në ofertë nga OE A.L.Dushi SHPK nuk kanë të specifikuar ASNJË shumë/vlerë, siç kërkohet në dosjen e tenderit:

Referenca me KFOR:



KFOR HEADQUARTERS
Support Group Site Manager Office
Film City, PRISTINA
KOSOVO

Phone: +381 38 503 603-2035

Phone: +381 38 503 603-2242



Date: 06.Jun.2026

Letter of Reference & Recommendation

Through this letter of reference, I would like to thank A.L DUSHI COMPANY with a Contract # 40006767 for professional and hard work that they did from for 2024, 2025 year still ongoing is doing Laundry Service in HQ KFOR.

Due to HQ KFOR confidentiality policies and contractual obligations, the contract values cannot be disclosed in this reference.

The Company A.L DUSHI was doing excellent job according to SCOPE OF WORK. KFOR never missed any day or any delay of bringing washed Laundry in HQ-KFOR since they have started working for us since 2010 until 2018.

A.L DUSHI was always ready to take any issue when dealing with customers, reliable respond to any of them.

Since 2010 A.L.DUSHI provides a laundry service for HQ-KFOR, the company understands clearly the SOW.
They provided both professional laundry and dry laundry service.

All work that is requested from KFOR and always is ready to complete on time and with very high level of professionalism/ quality and we wish and hope that they will continue to give their support for the future works.


ANDY MARLOW
OR-9 IRL-A
SITE MANAGER
KFOR HQ FILM CITY
PHONE: 049-750-341




MIMOZA ZHITIA-ZOGIANI
ASSISTANT SITE MANAGER/QAE
HSG/ HQ KFOR FILM CITY
PHONE: 049-750-341

Referenca me AMERICAN HOSPITAL KOSOVA SHPK

 Spitali Amerikan

"American Hospital Kosova" Sh.P.K.
Adresa: Rr. "Shkupi", Nr. 25,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Nr.tel: 038 221 661,
E-mail: info-ks@spitaliamerikan.com
Prishtinë, 01/07/2026

PËR TË GJITHA PALËT ME INTERES

LETËR REFERENCË "A.L. DUSHI" SH.P.K

I/E Nderuar,

"American Hospital Kosova" Sh.P.K. është institucion shëndetësor me Numër Unik Identifikues 810812158 dhe me licencë nga Ministria e Shëndetësisë me nr. 01/2022/S, i cili ofron shërbime shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Institucioni ynë është në marrëdhënie bashkëpunimi kontraktuale me kompaninë "A.L. Dushi" Sh.P.K. me numër unik identifikues 811250860, me adresë Rr. "Kosta Novaković", C4/2, Lam.B, nr.5, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për ofrimin e shërbimit të pastrimit të çarçafëve sipas kërkesave dhe nevojave të Spitalit Amerikan. Ne kemi themeluar marrëdhënie kontraktuale me kompaninë në fjalë që nga viti 2019.

Raporti ynë shtrihet në suaza bashkëpunimi por edhe përtej kësaj, në raporte profesionale dhe mirëbesimi të ndërsjellë.

Përmes kësaj shkrese deklarojmë se kompania ka dëshmuar seriozitetin e saj dhe ka kryer me sukses të gjitha shërbimet e pastrimit të çarçafëve, duke respektuar në përpikmëri afatet dhe të gjitha kërkesat e dakorduara mes palëve.

Kompania "A.L. Dushi" Sh.P.K. vazhdon kontratën për shërbime me institucionin tonë dhe ka dëshmuar seriozitetin e saj gjatë gjithë kohës kryerjes së shërbimeve.

Për çdo informacion shtesë, mund të na kontaktoni në adresat e sipër shënuara.

"AMERICAN HOSPITAL KOSOVA" SH.P.K.


z. Ledit BAZATI
Drejtor Menaxhues

American Hospital Kosova sh.p.k
Rr. "Shkupi", Nr.25, Prishtinë

038 221 661    www.spitaliamerikan.com

Pranimi i këtyre referencave nga Komisioni përbën shkelje të drejtpërdrejtë të NENIT 59 TË LPP-SË dhe NENIT 40 TË RRPP-SË si dhe të parimit të barazisë së trajtimit dhe të mosdiskriminimit ndërmjet operatorëve ekonomikë (NENI 7 I LPP-SË), duke favorizuar këtë OE.

Përveç kësaj në dosjen e tenderit tek kërkesa për reference është cekur:

Kërkesa 9 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses (jo në realizim e sipër) kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë totale jo më pak se 193,000.00 €

Sic shihet OE i propozuar për kontrata ka prezantuar në oferte referenca për kontrata që janë në realizim e sipër dhe jo për kontrata të përfunduara sepse referencat nuk përmbajnë numer kontrate, vlerë të kontrates dhe as datë të nënshkrimit të kontrates dhe as të përfundimit të qe edhe për këtë ka qenë kërkesa konkrete në dosjen e tenderit që kontratat nuk duhet të jenë në realizim e sipër si dhe dëshmia dokumentare që referencat apo raportet duhet të përmbajnë:

- numrin e kontratës prokurimit;
- vlerën e kontratës;
- datën e nënshkrimit të kontratës;

Është e pakuptueshme dhe absolutisht e papranueshme se si AK i injoroi kërkesat e qarta të dosjes së tenderit të cilën vetë e ka hartuar dhe publikuar dhe në vend që të eliminonte OE A.L. Dushi SHPK për mungesë të dëshmisë dokumentare thelbësore, e ka trajtuar këtë OE si të përgjegjshëm.

Si perfundim pasi që këto referenca nuk janë sipas kërkeses së dosjes së tenderit dhe autoriteti kontraktues ashtu sic ka cek në dosjen e tenderit nuk është dashur të marr parasysh fare dhe rrjedhimisht OE i propozuar për kontratë pa këto referenca nuk plotëson as për se afërmi kërkesën lidhur me referencat e që ka qenë referenca për kontratë në vlerë totale jo më pak se 193,000.00 € për 3 vitet e fundit.

III. Mospërbushja e kriterëve për Kapacitetin Teknik dhe Profesional — Mungesa e dëshmisë pronësore/të përdorimit për pajisjet e deklaruar (pika 11 e Dosjes së Tenderit)

Në dosjen e tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, është kërkuar, ndër të tjera:
"11. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e shërbimeve... c) Makina tharëse të rrobave (3 copë)"

dhe si dëshmi të detyrueshme dokumentare (Evidenca 11):

"c) Për pajisjet industriale: faturë blerjeje, dokument doganor (DUD), kontratë qiraje ose dokument tjetër relevant që dëshmon pronësinë ose të drejtën e përdorimit të pajisjeve."

Kjo kërkesë është e qartë, çdo pajisje duhet të shoqërohet individualisht me dëshmi konkrete dokumentare që vërteton pronësinë ose të drejtën e përdorimit, pa këtë dëshmi, pajisja në fjalë nuk mund të konsiderohet e vlefshme për qëllime të përmbushjes së kërkesës minimale.

OE i propozuar për dhënie të kontratës ka paraqitur në listën e pajisjeve tri (3) makina tharëse industriale, siç kërkohej numerikisht në dosje:

- Makinë industriale tharëse – Fibir (Itali), 15 kg
- Makinë industriale tharëse – Temel (Turqi), 15 kg
- Makinë industriale tharëse – Temel (Turqi), 35 kg

Mirëpo, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si dëshmi, rezultoi se për makinën "Fibir Italy 15 kg" OE nuk ka ofruar ASNJE dokument, as faturë blerjeje, as dokument doganor (DUD), as kontratë qiraje, as ndonjë dokument tjetër relevant që të vërtetojë pronësinë apo të drejtën e përdorimit të kësaj pajisjeje.

Meqë kjo makinë nuk është e dëshmuar dokumentarisht, ajo nuk mund të llogaritet si pjesë e vlefshme e kapacitetit teknik të deklaruar nga OE.

Si rrjedhojë OE i mbeten vetëm dy (2) makina tharëse (të markës "Temel") të dëshmuara siç duhet në ofertë dhe si rezultat i kësaj OE A.L. Dushi SHPK nuk e përmbush kërkesën lidhur me makinë tharëse

industriale, as kërkesën dokumentare (Evidenca 11.c) të përcaktuar në dosjen e tenderit, andaj komisioni i vlerësimit respektivisht AK është dashur të eliminojë automatikisht këtë OE dhe jo të shperblejë me kontratë.

AK, në Vendimin ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim, pretendon se: "Komisioni nuk e ka mbështetur konstatimin vetëm në listën vetëdeklaruese, por në listën e ndërlidhur me dëshminë e pronësisë dhe dokumentet doganore të pajisjeve."

Ky pohim është gjithashtu i pasaktë. Kemi shqyrtuar dosjen e plotë të ofertës së OE A.L.Dushi SHPK dhe konfirmojmë se për makinën "Fibir Italy 15 kg" nuk ekziston asnjë dokument doganor (DUD), faturë blerjeje, kontratë qiraje apo dokument tjetër që të vërtetojë pronësinë apo të drejtën e përdorimit të kësaj pajisjeje specifike. AK pretendon ekzistencën e një dokumenti që, sipas verifikimit tonë të drejtpërdrejtë të dosjes, nuk gjendet aty.

Kjo nuk është, siç ceke AK, "nxjerrje jashtë konteksti e një emërtimi tregtar" por është konstatim i thjeshtë dhe objektiv: ose dokumenti ekziston në dosje, ose jo. Nëse AK ka qene e sigurt se ky dokument ekziston, atehere perse nuk e ka prezantuar ne pergjigjen ndaj kerkeses per rishqyrtim.

Andaj bazuar ne kete konstatim OE A.L.Dushi SHPK nuk ploteson kerkesen per Kapaciteti Teknik dhe Profesional lidhur me *Makinat tharëse industriale të rrobave (3 copë)*" te kerkuara ne dosjen e tenderit dhe si i tille eshte dashur qe ky OE te eliminohet dhe jo te shperblehet me kontrate.

IV.Klasifikimi i padrejtë i ofertës sonë si "e papërgjegjshme"-Mungesa e katalogut

Arsyet eliminimit te ofertës tonë në letren standarde per tenderuesin e eliminuar:

Arsyet e Refuzimit te ofertës suaj:

1.Te Kërkesa 14: ne DT ka qen kriter se Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik që dëshmon kapacitetet dhe metodologjinë e ofrimit të shërbimeve të pastrimit të rrobave dhe mbulesave, duke përfshirë pajisjet që do të përdoren, detergjentët dhe mjetet e tjera për pastrim, programet e larjes dhe standardet e cilësisë që aplikohen gjatë procesit të pastrimit.

Evidenca 14:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogë, broshura ose fletë teknike të produkteve kimike që përdor për pastrim, si dhe përshkrimin e programeve të larjes, ku paraqiten temperaturat e larjes dhe dozimi i produkteve pastruese sipas llojit të artikullit.

Fletët teknike (Technical Data Sheets) dhe, sipas rastit, fletët e sigurisë (MSDS/SDS) për detergjentët dhe produktet kimike që përdoren.

Ju si OE me rastin e ofertimit perms platformes se sistemit te e-prokurimit, nuk e keni paraqitur ne system katalogun per produktet e ofruar sipas kërkeses (DT)

2. Mos plotesimi i dokumentacionit Teknik te kërkuar dhe mosperputhjes se temperaturave/programit sipas specifikave teknike te detyrueshme, te Aneksit 1 te DT, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion te plote teknik për programet e larjes, temperaturat dhe dorzimin e produkteve pastruese, sipas secilit artikull te specifikimit teknik.

Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar ofertën tonë si "të papërgjegjshme", duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë Nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40 të RRPP-së. Ky konstatim është krejtësisht i pambështetur në fakte dhe në kundërshtim flagrant me vetë kërkesat e dosjes së tenderit, për arsyet si vijon:

Oferta jonë ka qenë e plotë, e rregullt dhe konform në çdo aspekt me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në ofertën tonë kemi dorëzuar dokumentacionin saktësisht ashtu siç është kërkuar.

Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë formuluar shprehimisht si vijon:

"Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalog, broshurë ose fletë teknike të produkteve kimike që përdoren për pastrim..."

Ky formulim përmban lidhëzën "ose" dhe konfom kesaj ne kemi dorëzuar dokumentacionin teknik përkatësisht fletë teknike të produkteve kimike që përdoren për pastrim duke përmbushur kështu plotësisht kërkesën e dosjes së tenderit.

Te dhenat teknike per produktet qe perdoren per larje ne oferten tone gjinden ne dokumentin nr. 5 LISTA E PAJISJEVE Faqe 57-116

Komisioni i Vlerësimit e ka eliminuar padrejtësisht ofertën tonë me arsyetimin se "nuk kemi paraqitur katalog", duke injoruar plotësisht faktin se kjo kerkese eshte e formuluar me lidhezen "ose".

Andaj oferta jone është plotësisht e përgjegjshme dhe plotëson në përpikmeri kerkesat për te dhënat teknike për produktet qe do te përdoren.

Në përgjigjen e AK ndaj kësaj pike pretendohet se ky dokumentacion "nuk mundësonte verifikimin e karakteristikave teknike" dhe nuk kan dhënë asnjë specifikim konkret se çfarë saktësisht mungonte apo nuk përputhet, një arsyetim kaq i përgjithësuar nuk mund të justifikojë eliminimin e ofertes tone sepse oferta jonë përmban te gjitha karakteristiket teknike të kërkuara.

V.Klasifikimi i padrejtë i ofertës sonë si "e papërgjegjshme"-mungesë e dokumentacionit teknik"

Dosja e tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, nder tjera eshte kërkuar:

"Kërkesa 12: OE duhet të bëjë plotësimin, nënshkrimin, dhe vulosjen e Aneksit 1 [...] duke paraqitur të dhënat, emrin e prodhuesit, vendin e prodhimit si dhe specifikat teknike për produktet e ofruara."

dhe si dëshmi (Evidenca 12):

"Aneksi 1 i plotësuar, nënshkruar dhe vulosur nga OE. Mos plotësimi i Aneksit 1 do të eliminojë nga vlerësimi i mëtutjeshëm."

Komisioni i Vlerësimit e ka eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se nuk kemi plotësuar dokumentacionin teknik dhe mosperputhje te temperaturave/programeve sipas specifikave teknike te detyrueshme. Ky konstatim është i pabazuar dhe diskriminues, për arsyet si vijon:

Ne kemi plotësuar, nënshkruar dhe vulosur Aneksin 1 në tërësinë e tij

Ne kemi dorëzuar Aneksin 1 të plotësuar, nënshkruar dhe vulosur, siç kërkohej shprehimisht.

Në këtë aktivitet të prokurimit Aneksi 1 është formulari i vetëm zyrtar i përcaktuar nga AK për paraqitjen e këtyre të dhënave si dhe ne te eshte përshkrim i programeve të larjes, ku paraqiten temperaturat e larjes dhe dozimi i produkteve pastruese sipas llojit të artikullit, nuk ekziston asnjë formular apo shtojcë tjetër e veçantë e kërkuar shtesë për "specifikat teknike".

Duke plotësuar dhe nënshkruar këtë formular në përputhje me kërkesat e tij, ne kemi përmbushur të gjitha kërkesat siç janë përcaktuar në dosjen e tenderit.

Nëse Komisioni konsideron se ndonjë fushë specifike e Aneksit 1 nuk është plotësuar në nivelin e detajimit të pritur, ky do të ishte, në rastin më të keq, një mangësi e pjesshme dhe formale, e cila sipas Nenit 72 të LPP-së duhej të na jepte mundësinë e sqarimit, e jo eliminim të drejtpërdrejtë nga procedura.

Konsiderojme se perkundrazi OE i propozuar për kontratë ka bërë shkelje ne këtë pike pasi qe i njeiti ka nderhyre ne formularin e ANEKS 1 duke shtuar nje kolone anash dhe duke pershkruar! Do te ishte krejtesisht situatë tjetër nëse kolonën anash do te vendoste AK(sic bene zakonisht AK-Ministria e Mbrojtjes) atehere do te ishim te detyruar te paraqesim pershkrimin tone mirepo ne rastin e tanishem është kërkuar plotesimi i ANEKS 1 qe nënkuptohet vendet e percaktuara nga AK për plotësim.

Trajtim krejtësisht i pa drejtë nga komisioni i vlerësimit se pari ndaj kërkesave të dosjes se tenderit pastaj ndaj neve si ofertues te cilet kemi dorëzuar ofertën tonë te kompletuar dhe krejtësisht konform kërkesave te dosjes se tenderit.

Nëse do të kishte kuptim trajtimi juaj në këtë formë i kësaj kërkesë, lind pyetja përse nuk është eliminuar OE i propozuar për dhenje qe nuk ka paraqit ne dokumentin e ANEKS 1 prodhuesin dhe vendin e prodhimit sic ceket në kërkesë? Sigurisht se kjo nuk ka kuptim dhe nuk mund te trajtohet në këtë mënyre sepse nuk ka asnjë kolonë ku do te mund te plotësohet një përshkrim i tillë ne ANEKS 1.

Oferta jonë është krejtësisht ne përputhje me kërkesen ne dosjen e tenderit që ka qene plotësimi, nënshkrimi dhe vulosja e ANEKS 1, perkundrazi ne rast se do te benim dicka shtesë do te rrezikonim eliminimin sepse formulari nuk do te plotësohej ne formën dhe rubrikat e përcaktuara nga AK.

Si përfundim sa i përket arsyeve të eliminimit të ofertës tonë sqarojmë edhe njehere se:

- Specifikat teknike për produktet që përdoren për larje janë paraqitur ne ofertën tonë, gjinden ne dokumentin nr. 5 LISTA E PAJISJEVE Faqe 57-116.
- Është plotësuar aneksi 1 i dosjes se tenderit pikërisht sipas kërkesës se AK dhe ne rubrikat që AK ka paraparë për plotësim.

Si rrjedhojë oferta jonë plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikat e dosjes se tenderit.

Baza ligjore:

Neni 59 paragrafi 4 i Ligjit Per Prokurim Publik

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ne rastin konkret autoriteti Kontraktues ka propozuar per kontrate nje OE i cili nuk ploteson kerkesat e dosjes se tenderit ndersa ne anen tjetër ne jemi

eliminuar edhe pse plotesojme cdo kerkese te dosjes se tenderit.

Nenin 57 Sigurimi i tenderit dhe Neni 10 i UPP-se i cili percakton se sigurimi i tenderit duhet te kete permbajtje dhe forme sipas kerkeses se dosjes se tenderit ne te kunderten refuzo oferten pa kerkuar sqarime shtese.- Ne rastin konkret OE A.L. Dushi SHPK ka dorezuar sigurimin e tenderit ne kundershtim me formen dhe permbajtjen e sigurimit te vendosur nga AK ne dosjen e tenderit

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ne rastin konkret AK ka favorizuar OE A.L. Dushi SHPK, oferta e te cilit nuk ploteson kerkesat e kerkuara ne dosjen e tenderit. Njeherit na ka diskriminuar neve duke na eliminuar edhe pse oferta jone eshte krejtesisht e pergjegjshme dhe ploteson te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit.

Neni 40 paragrafi 6 i Rregullores per Prokurim Publik, citoj:

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Ne rastin konkret OE i propozuar per dhenje te kontrates nuk ploteson as per se afermi kriteret e perzgjedhjes ndersa oferta jone eshte plotesisht konform kerkesave te dosjes se tenderit.

Përmbledhje dhe Kërkesë Përfundimtare

Bazuar në të gjitha arsyet dhe bazat ligjore të paraqitura më sipër, konsiderojmë se vendimi i Autoritetin Kontraktues është marrë ne kundershtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar dhe plotësuar), si dhe të rregulloreneve dhe udhzuesit per Prokurim Publik.

Për këto arsye, përmes kësaj ankese kerkojmë nga OSHP:

- Të aprovojë këtë ankese si te bazuar;
- Të anulojë njoftimin mbi vendimin e AK dhe te kthej aktivitetin e prokurimt ne fjale ne rivleresim dhe,
- Te detyroje AK te bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me LPP-në, rregulloret në fuqi, dhe kerkesat e dosjes se tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëm të drejtpërdrejtë financiar për kompaninë tonë, për shkak të humbjes së një kontrate të konsiderueshme dhe kostove të investuara në përgatitjen e ofertës. Po ashtu, cenon konkurrencën e ndershme dhe krijon precedent negativ për tenderët e ardhshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.